VENDIM
Nr. 796, datë 9.11.2016

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS SË DURRËSIT, NË QYTETIN E FUSHË-KRUJËS", NË BASHKINË E KRUJËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksioni i Rrugës së Durrësit, në qytetin e Fushë-Krujës", në Bashkinë e Krujës.
2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Krujë.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë "tokë truall" me sipërfaqe 117,02 (njëqind e shtatëmbëdhjetë presje zero dy) m², dhe "objekt" me një sipërfaqe 40,7 (dyzet presje shtatë) m^2, me vlerë të përgjithshme të shpronësimit 3 346 779 (tre milionë e treqind e dyzet e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 3 346 779 (tre milionë e treqind e dyzet e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Krujë.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia Krujë.
6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit, në Bashkinë e Krujës, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo bashki.
8. Regjistrimi i ri i pasurive "tokë truall" me sipërfaqe 117,02 (njëqind e shtatëmbëdhjetë presje zero dy) m², dhe "objekt" me sipërfaqe 40,7 (dyzet presje shtatë) m^2, për realizimin e projektit "Rikonstruksioni i Rrugës së Durrësit, në qytetin e Fushë-Krujës", të bëhet në favor të Bashkisë Krujë.
9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Krujë dhe Bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E TË CILËVE DO TË SHPRONËSOHEN PËR "RIKONSTRUKSIONIN E RRUGËS SË DURRËSIT, NË QYTETIN E FUSHË-KRUJËS", BASHKIA KRUJË

Nr.	Emri mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërfaqja m² truallit që do të shpronësohet	Sipërfaqe objektit m²	Truall/ çmimi në lek/m²	Objekt/ çmimi në lek/m²	Vlera e përgjithshme në lek	Shënime
1	Ismet Eqrem Loci	1664	5/4	2.62		2795		7323	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Lulzim Eqrem Loci	1664	5/5	2.34		2795		6540	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Besnik Eqrem Loci	1664	5/3	3.36		2795		9391	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	Sabah Ahmet Stafuka	1664	6/163	4.02		2795		11236	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Sabah Ahmet Stafuka	1664	6/168	31.59		2795		88294	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	Gani Bajram Selaci	1664	5/9	14.17		2795		39605	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
6	Xhelal Hasan Riza	1664	5/10 5/198+1-2 5/199+1-2	11.58 7.14	11.58 2.25 1.43 7.14	2795 2795	76500 51000 51000 76500	1672082	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
7	K.I.Doku shpk(Hyqmet Doku)	1664	6/18	17.48		2795		48856	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
8	Arif Nazmi Disha Elsa Xhelal Disha	1664	N4/268+ 1-4		4.66		7 6500	356490	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
9	Bashkëpronësi e familjes Çela	1664	6/161	15.58		2795		43546	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
10	Xhumali Ali Cani	1664	N4/244		6.5		76 500	497250	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
11	Risel Avni Lezaj	1664	5/252	7.14	7.14	2795	76 500	566166	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
	Totali			**117.02**	**40.7**			**3 346 779**	